

ERMELA BROCI

“VENDI I DËSHMISË DHE KUJTESËS” NË SHKODËR SI NJË FORMË E RE KULTURORE E PËRKUJTIMIT

Abstrakt

Ngritja e muzeve të kujtesës vjen si një formë e re e muzeve të përkujtimit edhe në Shqipëri. Megjithëse në Europën Lindore kjo formë e muzeut është mjaft e përhapur, në Shqipëri janë të paktë muzetë që i kushtohen periudhës së komunizmit. Ky artikull do të rreket të shpjegojë pse dhe si shoqëritë pajtohen me të kaluarën dhe dhunën përmes krijimit të muzeve të kujtesës, si një formë e re kulturore e përkujtimit. Kështu, do të shqyrtojmë jo vetëm aspektet e së tashmes që tregojnë komunizmin nëpërmjet muzeut, por, më konkretisht, edhe tërësinë e praktikave me të cilat kryhet procesi i kujtimit brenda në muze. Një ekzaminim më i ngushtë për këtë do të bëhet për Muzeun e Kujtesës, në Shkodër, ku do të tregohet se si një qendër kulture dhe arsimit (1930-1946), që u përdor si burg politik (1946-92), u shndërrua në një muze kujtese (2014), për të përkujtuar krimet e komunizmit dhe për t’i bërë të njohura për publikun.

Fjalë kyçe: muzeu, komunizmi, kujtesa, politikat e kujtesës, Shkodra

Abstract

The museum of memory contours a new shape of memory and a new form of the museums in Albania. Although, in Southern Europe, this kind of museum is widely spread, there are very few museums in Albania dedicated to the Communist period. This article focuses on why and how the societies agree with the past and the violence through the creation of the museum of memory as a new form of the memorial museum. It is investigated not only the features of communism through the present museum but thoroughly the overall practices of the process of memory within a museum. The Museum of Memory, in Shkodra, northern Albania,

is taken as a case study. It is investigated its alterations through years starting as a cultural and education center during 1930-1946, later in 1946 - 1992 used as a political prison and then transformed into a memory museum (2014) to commemorate the crimes of communism and make them known to the public.

Keywords: Museum, communism, memory, memory politics, Shkodra

1. Hyrje

Me rënien e regjimit komunist dhe ndryshimet e shpejta në sistemin politik dhe ekonomik, krijimi i një muzeu dhe kujtimi komunist ishte lënë mënjanë si një çështje më pak e rëndësishme, që do të trajtohej më vonë. Dhe, pikërisht pas 25 vjetësh nga rënia e regjimit, u hap në Shkodër Muzeu i Kujtesës¹ për të përkujtuar krimet e komunizmit dhe për t'i bërë të njohura për publikun. Ky muze është ndër muzetë e parë të këtij lloji në Shqipëri, pas pavionit komunist në Muzeun Historik të Tiranës (hapur në vitin 1996), duke vijuar më pas me Bunk'Art 1 dhe 2 dhe, së fundmi, me Muzeun e Gjethit.²

Megjithëse nuk është e lehtë të krijohet një vlerësim i thellë i aspekteve teorike të kulturës së këtyre muzeve, që shpesh referohen në

¹ Gjatë tekstit, për lehtësi, do përdoret termi Muze Kujtese në vend të “Vendi i dëshmisë dhe kujtesës”.

²Projekti Bunk'Art filloi në nëntor 2014 me hapjen e një ekspozite të vendosur brenda bunkerit atomik të diktatorit Enver Hoxha, në periferi të Tiranës dhe vazhdoi më pas me hapjen e Bunk'Art 2, më 19 nëntor 2016 në qendër të kryeqytetit. Ndërsa Bunk'Art 1 i dedikohet historisë së ushtrisë komuniste shqiptare dhe jetës së përditshme të shqiptarëve gjatë regjimit, Bunk'Art 2 rindërton historinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë nga viti 1912 deri në 1991 dhe zbulon sekretet e "Sigurimit", që ishte arma e përdorur nga regjimi i Enver Hoxhës. Për më shumë, shih: <http://bunkart.al/2/faqe/ish-bunker-i-antiberthamor-i-ministrise-se-brendshme>, konsultuar për herë të fundit 14 prill 2020. Muzeu i Gjethit është hapur në vitin 2017, i njohur ndryshe si Shtëpia e Spiunëve, ajo u përdor nga Sigurimi i Shtetit për hetime. Për më shumë, shih: <http://muzeugjethi.gov.al/?lang=en>, konsultuar për herë të fundit më 14 prill 2020.

mënyra të ndryshme, si: muze burgu, muze komunizmi apo thjesht muze kujtese, ata mund të përshtaten me kujdes në kategorinë e turizmit të errët. (Broci 2018, 139) Muzetë e kujtesës janë muze të reja si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Ata reflektojnë mënyrën sesi shoqëritë kujtojnë të kaluarën dhe shpesh janë vendosur në vende simbolike, siç janë burgjet e komunizmit, kampet e përqendrimit apo institucione të tjera komuniste. Kjo strategji është quajtur "palimpsest monumental"³. Ndryshe nga muzetë historikë apo muzetë tradicionale që janë të përqendruar në mbledhje dhe shfaqje, këta ofrojnë një lloj të ri të angazhimit ndërveprues me të kaluarën, që përbën një kategori krejt të re të muzeut. Ata janë të përqendruar më shumë në edukimin dhe në krijimin e një përvoje për vizitorin. Pra, ndryshe nga muzetë tradicionale, ekspozitat e tyre janë boshe për t'i lënë vend narrativave dhe imagjinatës. Në vend që të tregojnë thjeshtë historinë e së kaluarës, këta muze kërkojnë që të bëjnë vizitorin ta "përjetojë" atë dhe të përfshihet emocionalisht. Gjithashtu muzetë, në veçanti, kanë një status të privilegjuar në shoqëri me një rol mjaft të rëndësishëm; ata janë hapësira ku zhvillohet "rituali i qytetarisë", ku vizitorët mësojnë se çfarë do të thotë t'i përkasë një grupi ose kombi (Duncan 1991), janë "komplekse ekspozuese" në të cilat shoqëria mëson vetë-rregullimin dhe disiplinën (Bennett 1999) dhe, më e rëndësishmja, ata kanë një "funksion legjitimues" (Huysen 1995), pra janë të mbushura me autoritet dhe konsiderohen si burimet më të besueshme. Ndryshe nga muzetë e tjerë, muzetë e kujtesës i përmbledhin të gjitha këto funksione.

Gjatë këtij punimi, përmes studimit të rastit të Muzeut të Kujtesës në Shkodër, do të shqyrtoj, kryesisht, pse dhe si shoqëria e përdor sot muzeun e kujtesës, si një mekanizëm për t'u marrë me të kaluarën dhe si mësohet (prezantohet) komunizmi në muze për të edukuar vizitorin, përmes narrativave të ekspozitave, për të inkurajuar emocionin dhe empatinë. Duke përdorur konceptin e përshkrimit dhe të konceptimit të muzeut, më kanë ndihmuar dhe "historitë e jetuara" brenda këtyre mureve. Gjithashtu, studimi i ekspozitave dhe dhomave të ish-burgut do të jenë në qendër të

³ Dy shembujt më të rëndësishëm të cilat diskutohen gjerësisht nga Dario Gamboni janë Kisha e Krishtit në Moskë dhe Kisha Regnum Marianum në Budapest. (Gamboni 1997, 71)

analizës. Qëllimi këtu nuk është të shpjegoj mënyrën se si ndihen vizitorët në këtë muze, por në atë që mund të quhet etnografi institucionale, në të cilin unë dokumentoj krijimin e një institucioni të përqendruar në disa pika: së pari, politikat e kujtesës të zbatuara në ish-shtetet komuniste si dhe krijimi i muzeve të kujtesës dedikuar periudhës komuniste, duke treguar ngjashmëritë mes tyre për të kuptuar më tej kontekstin kulturor dhe politik të konceptimit të këtyre muzeve; së dyti, krijimi i Muzeut të Kujtesës në Shkodër me fokus qëllimin që qëndron pas krijimit të muzeut si dhe historinë e ndërtesës së tij. Për këtë jam mbështetur në burimet dytësore dhe intervistat me individë të përfshirë në konceptimin e tij. Kjo zbulon se çfarë lloj eksperience ofrohet për vizitorin, si tregohet e kaluara, çfarë roli synohet në ndërtimin e një kulture demokratike; së fundi, është një lexim i ngushtë i ekspozitës, modelimit, organizimit, objekteve, fotografive, pamjeve dokumentare, dëshmisë dhe strategjive të tjera ekspozuese. Kam vizituar vetë muzeun dhe kam kaluar kohë në të, gjithashtu kam shqyrtuar dhe udhëzuesit e ekspozitës dhe kam përdorur burime parësore dhe dytësore në lidhje me mënyrën e organizimit të tij, si dhe arsyet e këtij prezantimi për të kuptuar më mirë nëse ky muze bën pjesë përmes funksioneve parësore në të qenit muze kujtese.

2. Politikat e kujtesës pas viteve '90 dhe muzetë e kujtesës së komunizmit

Po të ndalemi veçmas tek muzetë e kujtesës së komunizmit, ata përfshijnë një periudhë që fillon me rënien e komunizmit dhe vazhdon deri në ditët e sotme. Janë shumë muze të krijuar në Evropë gjatë dekadave të fundit. Leximet e së kaluarës, që ata propozojnë, ndryshojnë natyrshëm nga një vend në tjetrin, por kanë dhe disa karakteristika të përbashkëta, siç ishte rasti i ekspozitave të paraqitura në muze apo ligjërimi i tyre. Krijimi i një muzeu, zakonisht është rezultat i një procesi të gjatë që përfshin disa etapa: një vendim politik, një debat publik në parlament dhe në media, një ligj, i cili, gjithashtu, përcakton shumën e financimit publik për këtë iniciativë, rekrutimin e stafit, emërimin e një komiteti shkencor etj. Pra, një iniciativë e këtij lloji, kërkon mobilizimin e një pjese të tërë të shoqërisë dhe përmbajtja e muzeut shpreh vizionin që ka nga e kaluara. Kjo dhe arsyeja pse këta muze mund të konsiderohen si një tregues i kujtesës sociale në një moment

të caktuar theksojnë ndryshimin dhe mënyrën se si regjimet e reja kanë zgjedhur për t'u marrë me të kaluarën.

Ka shumë muze të këtij lloji në Europë, ku, ndër më të rëndësishmit, theksohen Shtëpia e Terrorit (Terrorhaza) në Budapest, Muzeu i Titos në Beograd (Serbi), Muzeu i Viktimave të Gjenocidit në Vilnius (Lituani), Muzeu i Pushtimit të Letonisë në Riga (Letoni), Muzeu i Pushtimeve në Talin (Estoni), Muzeu i Komunizmit në Sighetul Marmatiei (Rumani), Muzeu i Pushtimit Sovjetik në Tbilisi (Gjeorgji), Muzeu i Pushtimit Sovjetik në Kiev etj.⁴ Tipologjia e tyre është e ndryshme, disa janë

⁴*Shtëpia e Terrorit në Budapest* u hap në 24 shkurt 2002. Ai përmban ekspozite të lidhura me regjimet fashiste dhe komuniste në Hungarinë e shekullit të 20-të dhe, gjithashtu, është një përkujtim për viktimat e këtyre regjimeve, duke përfshirë edhe ata që janë arrestuar, marrë në pyetje, torturuar ose vrarë në ndërtesë. Muzeu, i cili është riemëruar së fundmi, si *Muzeu i Pushtimeve dhe Luftës së Lirisë* u krijua në 1992. Ai ndodhet në ish-selinë e KGB-së, prandaj shpesh mund ta gjejmë të referuar dhe si Muzeu i KGB-së. Muzeu është i dedikuar kryesisht për mbledhjen dhe ekspozimin e dokumenteve në lidhje me pushtimin 50-vjeçar të Lituanië nga Bashkimi Sovjetik, partizanë anti-sovjetikë të Lituanië dhe viktimat e arrestimeve, deportimeve dhe ekzekutimeve që ndodhën gjatë kësaj periudhe. *Muzeu i Pushtimit të Letonisë* i vendosur në Riga është krijuar në 1993 për të ekspozuar objekte, dokumente arkivore dhe për të edukuar publikun për periudhën 51-vjeçare në shekullin e 20-të, kur Letonia u pushtua nga BRSS-ja në 1940-1941, pastaj nga Gjermania naziste në 1941-1944 dhe, më pas, përsëri nga BRSS-ja në 1944-1991. Ky muze u krijua në vitin 2003 dhe i kushtohet periudhës së viteve 1940-1991, ku tregohet historia e Estonisë, kur vendi u pushtua nga Bashkimi Sovjetik, pastaj nga Gjermania naziste dhe më pas sërish nga Bashkimi Sovjetik. Muzeu është krijuar në ndërtesën e ish-burgut Sighet në vitin 1993. Rivendosja e ndërtesës së burgut u krye në vitin 2000. Çdo qeli burgu u kthye në dhomë muze, ku paraqitet kronologjikisht sistemi totalitar në Rumaninë komuniste. *Muzeu i Pushtimit Sovjetik* është një muze i historisë në Tbilisi të Gjeorgjisë, krijuar në 2006. Ai dokumenton shtatë dekadat e sundimit sovjetik në Gjeorgji (1921-1991). *Muzeu i pushtimit Sovjetik në Kiev*, Ukrainë u krijua në 2001. Aty tregohen krimet e regjimit sovjetik në Ukrainë (1917-1991). Ai u hap në fillim si një ekspozitë dhe në 2007 u kthye në një muze ku mori dhe emrin aktual. *Muzeu i Komunizmit* në Republikën Çeke (Pragë), është një muze i dedikuar për paraqitjen e një raporti të regjimit komunist pas

muze private, si p.sh., Muzeu i Komunizmit në Pragë, i cili paraqet historinë e komunizmit çekosllovak nga viti 1918, megjithatë pjesa më e madhe janë muze publike, krijuar nga iniciativat shtetërore dhe të financuara nga fondet publike. Si të tillë, ata përfaqësojnë një nga manifestimet më të rëndësishëm të politikave publike të kujtesës.

Në qoftë se shohim në brendësi ekspozitat e këtyre muzeve, mund të themi se, megjithëse tipologjitë apo politikat e kujtesës ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, tregimet që ata propozojnë kanë disa tipare të përbashkëta.

Së pari, mes atyre që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të kaluarën komuniste, më e dukshmjia është gjykimi plotësisht negativ i përvojës së komunizmit, ku ai përfaqësohet si e keqe absolute. Në ekspozitat e tyre fokusi është dhuna dhe terrori, të cilët paraqiten si elementi thelbësor i sistemit komunist: të gjitha aspektet e tjera të tilla, si: industrializimi, kultura, arsimi, përhapja e muzeve etj., janë të injoruara në përgjithësi.

Së dyti, karakteristikë e përbashkët është tendenca për të "transformuar" komunizmin, nëpërmjet interpretimit se shoqëria nuk është përgjegjëse për një fenomen të imponuar me forcë dhe nuk reflekton mbi konsensusin e, të paktën, një pjese të popullatës ndaj sistemit komunist, si edhe për episode mbështetjeje me komunistët gjatë kësaj periudhe. Por, është e qartë se, asnjë diktaturë nuk mund të zgjasë, nëse nuk arrin të krijojë një rreth bashkëpunimi rreth saj. Kështu, edhe në Shqipëri, komunizmi gjeti mbështetjen e një pjese të popullsisë, me anë të së cilës ka përmbushur qëllimet e tij. Gashi, në studimin e tij mbi llojet e burgjeve dhe kampeve të punës, tregon se, gjatë periudhës komuniste shërbenin në burgje kryesisht njerëzit nga lufta, të cilët shquheshin për besnikëri të lartë ndaj Partisë Komuniste, por që nuk kishin ndonjë përgatitje të duhur për punë në burgje. Shumë prej tyre ishin të pashkolluar, ose me disa klasë mësimore (Gashi 2012, 43). Gjithashtu, paralelisht me përfaqësimin e shoqërisë si një viktimë e pafajshme, tregimet e ekspozitave postkomuniste nxjerrin në pah episodet e rezistencës ndaj komunizmit dhe japin përshtypjen se shoqëria gjithmonë ka kundërshtuar në mënyrë aktive regjimin.

Luftës së Dytë Botërore në Çekosllovakia në përgjithësi dhe Pragës në veçanti. *Muzeu i Komunizmit* ofron një vështrim të thellë në jetën pas Perdes së Hekurt.

Së treti, ekspozitat e komunizmit kanë si qëllim të jenë ekspozita anti-komuniste dhe në këtë mënyrë të edukojnë qytetarin post-komunist me mesazhin që "kjo periudhë mos të përsëritet më". Një shembull është shprehja njohur e George Santayana-s, nga *The life of reason* (1905) e përdorur në të gjithë këta lloje muzesh "Popujt që harrojnë të kaluarën, detyrohen ta përsërisin atë". Këtë e gjejmë në Muzeun e Kujtesës në Shkodër, në memorialin dhe muzeun Auschwitz-Birkenau, Terrorhaza në Budapest, Memoriali Sighet në Rumani etj. Në rastin e Muzeut të Kujtesës në Shkodër synimi është i qartë: u krijua për të siguruar kujtesën rreth periudhës së komunizmit, të përqendruar në qytetin e Shkodrës, krijimin e një kujtimi kolektiv të bazuar në pjesëmarrjen e viktimave, dhe se një kujtim i tillë do të përdorej për të reflektuar mbi te ardhmen:

"asht një ndërmarrje serioze që bahet me pengue harresën, harresën e madhe që ka mbulue vendin tonë për afër 23 vjet me rradhë e që rrezikon jo vetëm shuemjen e efekteve shkatërrimtare, kriminale dhe asgjasuese të ish-rregjimit komunist në Shqipëri, por akoma më keq rrezikon rivlerësimin, ringjalljen dhe eventualisht përsëritjen e atij kobi të zi që mbuloi vendin tonë për ma shumë se 45 vjet të gjata!"⁵

Ligjërimit në këta muze është i ngjashëm, ato na vijnë si "premtime" arendtiane, të bëra nga shoqëritë për të ardhmen, për të garantuar se nuk do të lejohet kurrë më kjo dhunë dhe mizori. Siç e përshkruan Arendt:

"premtimi është një formë e kontratës sociale që na lejon të jetojmë së bashku në botë. Ne nuk mund të marrim përsipër veprime të kryera më parë, por mund të premtojmë se nuk do të bëjmë përsëri dëm në të ardhmen. Kështu, kombet dhe grupet që ndërtojnë muze të kujtesës kërkojnë t'i tregojnë pjesës tjetër të botës dhe popullsisë së tyre angazhimin e tyre për një të ardhme të ndryshme. Ndërsa ata nuk mund të zhbëjnë atë që është bërë". (Arendt 1958, 244)

Këta muze përpiqen të krijojnë një kontratë të re me njerëzit e tyre, me njerëzimin dhe me brezat e ardhshëm, që akte të tilla nuk do të lejohen

⁵Bushati, Ahmet. "Muzeu i viktimave të komunizmit në Shkodër -Fjala e Ahmet Bushatit". *Shkrime nga Lazër dhe Jozef Radi*, 27 shtator 2014, konsultuar për herë të fundit me dt. 18 prill 2020, <http://www.radiandradi.com/muzeumi-i-viktimave-te-komunizmit-ne-shkoder-fjala-e-ahmet-bushatit/>.

në të ardhmen. Këto premtime janë të dukshme në fjalimet e mbajtura në hapjen e Muzeut të Kujtesës në Shkodër: “është thënë e provuar se një popull pa kujtesë historike është i destinuar të përsërisë të kaluarën e tij dhe këtë e provon çdo ditë jeta jonë politike e shoqërore”⁶ si dhe në narrativën e ekspozitave.

Së fundmi, këta muze, secili në tipologjinë e tij, përcjellin dhe mesazhe politike, modelet e tyre mbështeten nga politika mbizotëruese e kujtesës në shoqëritë e tyre, për shembull, në rastin në fjalë, Muzeu i Kujtesës u inaugurua më shtator 2014 nga qeveria në pushtet asokohe⁷ dhe qëllimisht për të përkujtuar viktimat në atë vend. Këtu vlen të përmenden disa aspekte, duke filluar me vetë emrin, Vendi i dëshmisë dhe kujtesës, i cili menjëherë sinjalizon përmbajtjen dhe kuptimin e muzeut: historia e së kaluarës në Shkodër reduktohet në një dimension të vetëm, atë të kujtesës dhe dëshmisë. Në këtë mënyrë, duke i lënë mundësinë muzeut të funksionojë edhe si një memorial. Muaji i inaugurimit të muzeut në shtator rezulton të jetë me shumë simbole: së pari, Kryengritja e Postribës ka ndodhur në shtator të 1946.⁸ Po në shtator kanë vdekur edhe Marie Tuci dhe At Zef

⁶Po aty.

⁷ Megjithëse muzeu u hap në vitin 2014, (vit në të cilin PS (partia socialiste) ishte në pushtet), ai ishte iniciativë e qeverisë së kaluar, d.m.th. Partisë Demokratike (2009-2013), shih: Shllaku, Brikena. “Burgu i Sigurimit, ferri i klerikëve”. *Shkodra Online*, 23.10.2008, konsultuar për herë të fundit më 28 prill 2020, <http://www.shkodraonline.com/comment.php?comment.news.1977>.

⁸ Kryengritja e Postribës ishte një lëvizje popullore e armatosur, ndër të parat e këtij lloji në gjithë Evropën Lindore. Me 9 shtator të vitit 1946, forcat antikomuniste nën udhëheqjen e Jup Kazazit dhe Osman Haxhisë, synuan të merrnin Shkodrën. Mungesa e organizimit dhe moskoordinimi i veprimtarisë me forcat antikomuniste në qytet dhe në fshatrat përreth, solli dështimin e kryengritjes. Forcat e armatosura komuniste, që ishin në dijeni përmes infiltrimit në radhët e kryengritësve të punonjësve të Sigurimit të Shtetit, arritën ta shtypnin brenda së njëjtës ditë këtë lëvizje. Nën udhëheqjen e Zoi Themelit, i cili ishte drejtor i Mbrojtjes së Popullit për qytetin e Shkodrës, në qytet dhe në fshatra filloi vala e egër e terrorit komunist e shoqëruar me pushkatimin pa gjyq të 12 vetëve. Të nesërmen dhe në ditët në vijim të muajit, nuk pushuan vrasjet, burgosjet dhe internimet në krahinën e Postribës. Ky fat do të pasonte edhe qytetin e Shkodrës,

Pllumi, rrëfimet e të cilëve, si të burgosur, janë ndër kryesoret e këtij muzeu⁹. Funksioni kryesor i muzeut është përkujtimi i viktimave të regjimit komunist. Mund të mendojmë gjithashtu se kjo mund të konsiderohet dhe pjesë e fushatës zgjedhore të partisë në pushtet (Partia Demokratike). Krijimi i muzeut ishte pjesë e politikës së kujtesës të zbatuar nga qeveria, (2009-2013), instrumenti kryesor i të cilit ishte Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Bashkia Shkodër.

Në të gjitha rastet, duke lënë qëllimisht në hije çdo gjë që nuk përputhet me leximin që duam t'i japim së kaluarës, rezulton se ndërtimi i këtyre muzeve ka pjesë të rëndësishme periudhën e komunizmit dhe historinë e këtyre vendeve dhe e përgatit vizitorin që në këto ekspozita nuk do të përballen me objekte dhe përshkrime, por do tregohet komunizmi si një fenomen tërësisht dhe ekskluzivisht negativ, si një e keqe absolute, për të zgjuar emocionalitetin dhe empatinë tek ata. Bazuar në këtë, muzetë e kujtesës, ashtu si muzetë e tjerë, janë institucione politike dhe se kujtesa, madje edhe ajo e së kaluarës negative mbetet në kontrollin e saj.

3. Nga burg, në muze kujtese - Zhvillimet historike të godinës

Përfshirja e zhvillimeve historike të godinës shihet mjaft e nevojshme në këtë punim për të treguar se muret e këtij muzeu janë argumenti më i fuqishëm i transformimit të vazhdueshëm, duke kaluar nga një vend arsimi, më vonë, shërimi e, më pas, në qendër vuajtjesh dhe torture. Informacioni i marrë nga dokumentet arkivore dhe nga vetë përgjegjësi i muzeut na ndihmon të krijojmë një histori kronologjike të godinës nga ndërtimi i saj dhe deri në marrjen e pushtetit nga komunistët.

Rezulton se ndërtimi i godinës e ka pikënisjen në gjysmën e shekullit XIX me projektimin e ndërtesës nga Arsen Idromeno, si një shtëpi private

në të cilin arrestimet do të ishin të shumta, sidomos kundër shtresës intelektuale dhe familjeve më të pasura të qytetit. Shih: (Butka 2013).

⁹Marie Tuci vdiq nga torturat e shumta në spitalin e burgut në Shkodër, më 24 shtator 1950. Ajo u lind në fshatin Mirditë në 1928 dhe u arrestua më 1949, në kohën që pritej t'i bashkohej urdhrin të motrave stigmatine si murgeshë. At Zef Pllumi vdiq në shtator të vitit 2007. Në vitin 1931 hyn në Kolegjin Françeskan të Shkodrës dhe në vitin 1967 do të rikthehej aty, por si i burgosur.

për familjen e Rrakacollëve.¹⁰ Në vitin 1908, ndërtesa u ble nga Mbretëria Austro-Hungareze dhe aty u vendos të ndërtohej një konvikt. Këtë funksion e pati deri më 1916-n, ku i shërbeu fëmijëve të malësorëve të varfër dhe fëmijëve jetimë. Në vitin 1917 ky aktivitet ndërpritet, pasi Lufta e Parë Botërore ishte në kulmin e saj dhe vëllezërit e shkollave të krishtera u morën ushtarë në front, duke bërë kështu që konvikti të mbyllej përfundimisht. Me mbarimin e luftës, ndërtesa i dhurohet Arqipeshkvisë së Shkodrës si shpërblim dëmsh, më vonë Arqipeshkvi, Imzot Jak Serreqi, ia lëshon në përdorim Bashkisë së qytetit dhe në vitin 1918-1930, Bashkia Shkodër, vendos që në këtë ndërtesë të transferohej spitali civil: “Tue qene se në vitin 1923 u çel spitali ushtarak shqiptar, në ndërtesën e tij u instalue ky dhe spitali civil që u çue në ndërtesën e ish-konviktit të Schulbruderve, në shtëpinë e Rrakacojve dhe aty qëndroi deri me 1928.”¹¹

Në vitin 1930, spitali transferohet në një ndërtesë tjetër dhe ndërtesa blihet nga Provinca Françeskane Shqiptare, duke transferuar këtu kolegjin e tyre.¹² Kolegji e vazhdoi funksionin e tij deri me ardhjen në pushtet të partisë komuniste, e cila filloi një valë të gjerë persekutimi, terrori dhe arrestimesh, sidomos kundër etërve françeskanë si pasojë e dy kryengritjeve të para antikomuniste që ndodhën në zonën e Shkodrës.

Kështu numri i burgjeve dhe i personave të dënuar në fillim të viteve të diktaturës do të ishte i lartë. Goditja e parë që i bëhet qytetit ndodh në datat 28 janar - 2 shkurt 1945, kur shpallet dhe gjendja e shtettrrethimit

¹⁰Arsen Idromeno ishte babai i Kolë Idromenos (1860-1939). Në atë kohë ai erdhi në Shkodër nga Parga dhe ishte i njohur për aftësitë e tij si marangoz dhe projektues shtëpish. Vendi për ndërtimin e saj ishte i përshtatshëm, pasi ishte në qendër dhe hapësirat ishin të bollshme, me hyrje në katër anët e qytetit dhe oborre e kopshte të mëdha. Për më shumë shih: Prendushi 1984.

¹¹IAKSA. Arkivi i Etnografisë, Fondi: Kolë Gurashi dhe Gjush Sheldia, Dosja 105/27, viti 1958-59, fl. 11.

¹²Duke qenë se Kolegji Françeskan nuk kishte një hapësirë të veten atëherë Provinciali Atë Vinçens Prennushi, vendosi që të blejë këtë ndërtesë, pronë e Arqipeshkvisë Shkodër. Kështu ai pagoi 6000 napolona ari tek Imzot Lazër Mjeda dhe ditën e Zojës së Shkodrës, në tetor të vitit 1930, kolegji i ri zuri vend në ndërtesën e re, duke lëvizur nga godina e shkollës fillore, ku qëndronte deri atëherë. (Mirdita 2017, 112)


ushtarak. Nisin bastisjet dhe arrestimet e paligjshme në qytet, sipas listave të parapërgatitura. Kjo bëhej për qëllime të caktuara. Haxhi Sulo dhe Pëllumb Kaso theksojnë se, zakonisht plani i arrestimeve caktohej nga lart dhe ishte direktivë që duhej përmbushur për dy qëllime: të sigurohej kontingjenti sa më i madh i të dënuarve për punët pa pagesë dhe të frikësohej pjesa tjetër e popullsisë në mënyrë që ajo të bëhej e dëgjueshme (Sulo dhe Kaso 1995, 4). Kjo bëri që burgjet të mbusheshin plot me të burgosur nga të gjitha shtresat, sidomos nga shtresat intelektuale dhe më të rëndësishme të qytetit.

Duke pasur informacione se dhunës i përgjigjeshin me veprime që shprehnin protesta, në Shkodër nisën gjyqet me dyer të mbyllura mbi klerin katolik. Kështu nisën arrestimet e një grupi të madh priftërinjsh, studentësh të seminarit jezuit, fshatarësh dhe ushtarakësh të akuzuar se kishin formuar organizatën "Bashkimi kombëtar" si dhe me pretekstin e fshehjes së armëve në altarët e kishave me shpresën se do të diskretitonte klerin në sy të popullit. Numri i lartë i të burgosurve do të bënte që të mos kishte hapësira të mjaftueshme, kështu që regjimi mendoi të konfiskonte shtëpi apo objekte private, të cilat i përkisnin familjeve më në zë shkodrane, duke i improvizuar ato në burgje. Me datë 6 mars 1946, me vendim qeverie, u sekuestruan të gjitha pronat e Etërve Françeskanë.¹³ U mbyllën të gjitha shkollat private françeskane dhe, bashkë me to, edhe kolegji. Ndërtesa u sekuestrua me gjithçka kishte dhe në të zuri vend Sigurimi i Shtetit. Burgu i Sigurimit u përrurua nga administrata e sapokrijuar komuniste në vitin 1949, ish-Dega e Punëve të Brendshme:

"Tue mos llogaritë "Burgun e madh" të Shkodrës të mbushun qysh dy vjet ma parë me ish-zogistë e të rinj ballistë, mbas ngjarjeve të Kryengritjes së Postribës, pushtetit komunist do t'i dilte nevoja që

¹³Vendim i këshillit Ministerial, datë 06.03.1946: Të mbyllen të gjitha institutet shkollore të çdo natyre dhe të çdo grade të mbajtur dhe të drejtuar prej klerit katolik; të mbyllen të dy seminarët, ai françeskan e ai jezuit; shpërndarjen e organizatave e shoqërive të ndryshme, si dhe ndalimin e çdo veprimtarie të tyre; rekuizimin e gjithë pronës së këtyre organizatave, instituteve dhe shoqërive, qoftë të luajtshme ose të paluajtshme; konfiskimin e gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit jezuit; gjithë kjo pronë konsiderohet pronë shteti dhe marrja në dorëzim të bëhet menjëherë. Vendim i firmosur nga Enver Hoxha.

për të 1200 të arrestuemit e atyne ditëve, të kthente në burgje plot 13 ndërtesa të mëdha publike e private, prej ku të burgosunit e tyne simbas radhës e si nëpër vrimë të gjylpanës, do të përshkoheshin nëpër këtë burg. Me tortura shumë të randa fizike e presione morale, do të kërkohej nga viktimat të pranonte para hetuesve kriminelë e sadistë të Sigurimit akuza për pjesëmarrje në ngjarje që nuk kishin ngja fare. Fantazi djallore!”¹⁴



Ndërtesa e Sigurimit¹⁵

Pra, kjo ndërtesë u bë një nga 13 burgjet dhe 13 shtëpitë e hetuesisë që kishte Shkodra në atë kohë. Duke u mbështetur në literaturën mbi burgjet si dhe në të dhënat arkivore dhe dëshmitë e personave të dënuar të kësaj periudhe kohore, mund të konstatohet se këto ndërtesa ishin:


1. **Burgu i Kishës së Fretënve**
2. **Shtëpia e Pjetër Çurçisë**
3. **Konvikti “Malet tona”**

¹⁴“Fjala e mbajtur me rastin e përvitmit të muzeut të viktimave të komunizmit në Shkodër” *Gazeta Dielli*, 22 shtator 2014, konsultuar për herë të fundit më 25 prill 2020, <https://gazetadielli.com/shkoder-muzeumi-kunder-harreses/>.

¹⁵Fotoja është marrë nga: Bushati 2007, 17.

4. **Seksioni i Mbrendshëm: Hetuesi, ku ishte "Seksioni Katolik Shkodër", ndoshta i vetmi Seksion në Shtetet komuniste të Europës.**

5. **Burgu i vjetër i Gestapos**
6. **Shtëpia e Ulqinakut**
7. **Kuvendi i motrave servite**
8. **Kisha e motrave servite**
9. **Shkolla e Çelës**
10. **Bodrumi i shtëpisë së Fasli Ademit**
11. **Shtëpia e Rrojeve**
12. **Burgu i Çekës**
13. **Shtëpia e Lec Shkrelit**
14. **Shtëpia e Dr. Karamitrit**
15. **Shtëpia e Sandër Saraçit**
16. **Hoteli i Bepit Mishiçit**
17. **Shtëpia përdhese e Vuksanëve**
18. **Burgu i Postës**
19. **Burgu i ushtrisë**
20. **Burgu i prefekturës**
21. **Toga e ndjekjes së Sigurimit**
22. **Shtëpia e Guljelm Sumës**
23. **Shtëpia e Guljem Lukës**
24. **Burgu i madh (pranë Prefekturës)**
25. **Spitali i burgut (përballë Shtëpisë së Kulturës)**
26. **Spitali i burgut**



Harta e burgjeve komuniste në qytetin e Shkodrës (1944-1962)¹⁶

Kolegji i Françeskanëve u kthye në një qendër transferimi dhe torturash që iu bënë intelektualëve (akademikë, ekonomistë, zyrtarë, historianë, politikanë dhe priftërinj) nga regjimi diktatorial i asaj kohe. Megjithatë, ai nuk funksionoi vetëm si burg politik, por edhe për të burgosurit ordinerë. Të dhënat tregojnë për rreth 136 të vdekur dhe 2846 të burgosur politikë dhe 1924 të internuar politikë:

“Nji nga “prété” ma të para të diktaturës në atë kohë do të ishin intelektualët me formim perëndimor e patriotik, mes të cilëve edhe disa të papërsëritshëm për kulturën e gjanë që kishin, e që si elemente të pakonformuem me komunizmin, do të vriteshin njeni mbas tjetrit, ose të dergjeshin për vite të tana mbrenda burgjeve të diktaturës.

Për shumë vite me radhë, pjesë e këtij ish-burgu kanë kenë edhe tregtarët, sidomos tregtarët e mëdhenj të Shkodrës.”¹⁷

¹⁶Foto: Ermela Broci, *Muzeu i Kujtesës*, janar 2018. Të gjitha fotot në vijim janë bërë nga vetë autorja, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe.

Sekuestrimi i ndërtesës bëri që të kishte ndërhyrje në arkitekturë për t'iu përshtatur funksionit të saj të ri:

“Ndryshimet më të mëdha do ndodhnin në pjesën fundore të godinës, aty ku ishin të vendosura magazinat, tashmë të ish Kolegjit Françeskan. Pikërisht këto magazina do të shndërroheshin totalisht dhe vendin e tyre do e zinin qelitë e paraburgimit dhe dhomat e hetuesisë... Hyrja ishte në mes të kësaj godine përdhese, trekatër metra e gjatë dhe e ndante burgun majtas e djathtas në dy korridore, ku secili prej tyre zgjatohej me nga shtatë çifte dyer qelie të vendosura simetrikisht përballë njëra-tjetrës, duke qenë kështu përfundimisht 14 të tilla që binin nga krahu i oborrit dhe 14 të tjera përballë tyre që binin nga ana e errët, që merrnin pak dritë prej një korridori që mezi ndriçohej prej 2 dritareve të vogla, nga një në secilin skaj të tij.” (Mirdita 2017, 113)

Me ndryshimin e sistemit qeverisës në vitin 1992, godina vazhdoi të njëjtin funksion, por tashmë jo më si Dega e Brendshme e qytetit të Shkodrës, por si Komisariati i Policisë së qytetit. Hapësirat vazhduan të kishin të njëjtin rol si gjatë periudhës së diktaturës. Qelitë kishin po të njëjtin funksion si qeli paraburgimi. Komisariati i Policisë qëndroi në këto ambiente deri në vitin 1997. Pas këtij viti, shteti ia riktheu pronën Provincës Françeskane Shqiptare, e cila më vonë ia kaloi Motrave Klarisë, të cilat do të themelonin Manastirin e tyre të “Shën Kjarës” me datë 29 tetor 2005. Më pas, manastiri, që kishte në pronësi objektin, ia vuri në dispozicion Bashkisë së Shkodrës për kthimin e ish-burgut dhe ish-mjediseve që përdorte sigurimi i shtetit në një objekt muzeor. Projekti u miratua në Ministrinë e Kulturës, e cila dha një fond për rikonstruksionin e nevojshëm të ambienteve dhe në shtator 2014 u hap për publikun “Vendi i Dëshmisë dhe i Kujtesës”. U përdor termi "vend" për të treguar se muzeu përqendrohet në aspekte të caktuara të historisë në Shkodër.

¹⁷Bushati, Ahmet. “Muzeu i Viktimave të komunizmit në Shkodër-Fjala e Ahmet Bushatit”. *Shkrime nga Lazër dhe Jozef Radi*, 27 shtator 2014, konsultuar për herë të fundit më 18 prill 2020,

<http://www.radiandradi.com/muzeumi-i-viktimave-te-komunizmit-ne-shkoder-fjala-e-ahmet-et/>.

Edhe ky muze, ashtu si muzetë e tjerë të kujtesës, ka një mision përtej muzeve tradicionalë. Ai kërkon jo vetëm të kujtojë viktimat, por edhe të shërbejë si një hapësirë e historisë dhe e edukimit, me detyrë kryesore edukimin moral të vizitorëve të tij. Pierre Nora ka shkruar për "rikuperimin e kujtesës" që ndodhi me rënien e komunizmit në 1989.¹⁸ Ky rikuperim solli përmbysje kujtimesh nga periudha komuniste, duke ndërlikuar kujtesën në botën postkomuniste dhe duke paraqitur sfida të mëdha në përfaqësimin e së kaluarës, sidomos të muzetë e kujtesës. Duke përdorur nocionin e Nora-s për "rikuperimin e kujtesës", më poshtë do të analizoj narracionin e ekspozitës dhe strategjitë e përdorura nga muzeu për të shfaqur të kaluarën, gjë që na ndihmon të kuptojmë se si shfaqja në këto muze vjen shpesh si zgjidhje për t'u marrë me të kaluarën, ku rimarrja e "kontrollit" të kujtesës duket thelbësore për luftën kundër komunizmit dhe për të ardhmen. Rimëkëmbja e kujtesës së Nora-s mund të shihet si një kapital i rëndësishëm politik për regjimet e reja që përpiqen të ecin përpara. Po të marrim rastin e Shqipërisë, e cila ka pasur një marrëdhënie jo të lehtë të periudhës kalimtare, me lëkundje mes thirrjeve për hapjen e dosjeve, ndjekjes penale apo spastrimin e ish-zyrtarëve komunistë nga qeveria, duket që këto muze vijnë si një zgjidhje e mundshme për t'u marrë me të kaluarën.

4. Në brendësi të ekspozitës....

Tre janë funksionet parësore të këtij muzeu që e bëjnë kategorikisht pjesë të muzeve të kujtesës, duke tejkaluar rolin tradicional të muzeve:

Së pari, ka funksionin e një memoriali, i cili shërben si një hapësirë e kujtesës dhe për të bërë drejtësi për viktimat që ai përfaqëson.¹⁹ Karakteri përkujtimor kuptohet me anë të vendit, hapësirës, objekteve dhe tekstit dhe kjo bëhet e shqueshme në brendësi të ekspozitës. Si fillim, hyrja në ekspozitë prezantohet me anë të një skulpture që shfaq një njeri të ulur në

¹⁸ Nora, Pierre. "Reasons for the current upsurge in memory", *Eurozine*, 19 prill 2002, konsultuar për herë të fundit më 25 prill 2020, <https://www.eurozine.com/reasons-for-the-current-upsurge-in-memory/>.

¹⁹ Edhe muzetë e kujtesës nëpër botë kanë këtë funksion të dyfishtë. P.sh., Muzeu Përkujtimor i Holokaustit në Washington DC, apo Muzeu i Auschwitz- Birkenau në Poloni.

gjunjë, të rrethuar me tela me gjemba, që në simbolikën e saj mbart në mënyrë të qartë të gjitha shenjat e arkitekturës monumentale të viktimës. Simbolika e mëtejshme e ekspozitës theksohet nga prania e kryqit nëpër qelitë e burgut-muze, shoqëruar me fotot e personave që kanë kaluar vite në ato qeli, janë torturuar dhe kanë vdekur aty si dhe nga fotot e viktimave që i përshtaten plotësisht kategorisë së artit përkujtimor në kuadër të ekspozitës.



Këtë e konfirmon edhe vetë iniciatori i krijimit të këtij muzeu:

“Me rastin kur ne po kthejmë në muze një prej ish-burgjeve me histori ma të veçantë torture e krimi, ne jo vetëm që përpiqemi të shlyejmë një detyrim tonin ndaj ish-viktimave të shumta të këtij ish-burgu ferr, por, në të njëjtën kohë, qoftë edhe për pak çaste po mundohemi të “ringjallim” një kohë të shkueme me ngjarje e njerëz, sot në prag të një harrese të plotë, me imazhet e trishtueshme të 137 viktimave që mbrenda këtij burgu, dikur patën nxjerrë frymën e fundit”.²⁰

Së dyti, është historia dhe origjinaliteti, pra roli i muzeut në tregimin e historisë, si dhe origjinaliteti i godinës në ruajtjen e së kaluarës. Në fakt, shumica e muzeve të kujtesës të komunizmit kanë një objekt unik që shërben si burim autenticiteti për të gjithë ekspozitën dhe, në rastin tonë, ndërtesa është vendi ku kanë ndodhur ngjarjet dhe luan rol mjaft të rëndësishëm për historinë që tregon. Kjo është dhe pjesa më autentike e

²⁰Bushati, Ahmet. “Muzeu i Viktimave të komunizmit në Shkodër-Fjala e Ahmet Bushatit”. *Shkrime nga Lazër dhe Jozef Radi*, 27 shtator 2014, konsultuar për herë të fundit me dt. 18 prill 2020,

<http://www.radiandradi.com/muzeumi-i-viktimave-te-komunizmit-ne-shkoder-fjala-e-ahmet-et/>.

këtij muzeu, duke e bërë më tërheqëse për vizitorin. Wight argumenton se bota postmoderne krijon një publik që e dëshiron dhe e kërkon autentiken dhe realen (Wight 2009, 134). Ky kërkim për autenticitetin ka bërë, gjithashtu, shenjën e tij mbi konsumin e turizmit, me zhvillimin e “turismit të errët”, i cili kërkon autentiken nëpërmjet njohurive dhe përvojave të reja. Edhe në rastin në fjalë përvoja që ofrohet është autentike, ku vizitorëve i ofrohet një eksperiencë e plotë nëpërmjet ruajtjes së gjithë strukturës së mëparshme, si dhe objekteve origjinale të vendosura në qelitë e burgut. Arkitekti Viktor Dhimgjini shpjegon se përzgjedhja e këtyre elementeve tenton të rikujtojë ngarkesën dhe dhunën e fortë psikologjike që shkaktonte "rruga" nga hetuesia në qeli:

“Gjerësia e galerisë është e tillë që të shërbejë si rrugë kalimi njëkohësisht dhe si hapësirë muzeale, por përpjekjet tona janë që muzeu të flasë edhe kur të jetë "i zbrazur". Kalimi nëpër galeri do të shoqërohet me efekte audio, fonia stereo do të shpërndajë lehtë fragmente origjinale thirrjesh të burgosurve, deponime, rënkime, lutje, heshtje etj.”²¹

Bazuar në këtë, muzeu e jep mesazhin e autenticitetit duke përdorur vërtetësinë e hapësirës së kësaj ndërtese që, për pjesën më të madhe të qytetit të Shkodrës, ishte simbol i frikës. Pra, duke qenë brenda një qelie të burgut të vërtetë (ish-burgu i Sigurimit), vizitorëve u ofrohet takimi i vërtetë me muret që panë vuajtjet e të burgosurve, duke u ofruar në këtë mënyrë përvojë të drejtpërdrejtë për persekutimin politik në vend, duke i ofruar një imazh autentik të regjimit në periudhën komuniste. Në përshtypjet e vizitorëve lënë për muzeun e kujtesës, duket se besimi që njerëzit kanë në muze si hapësira të së vërtetës dhe të autenticitetit, shoqëruar me ndikimin emocional të historisë së këtij muzeu, është me të vërtetë bindës dhe ka efektin e dëshiruar: “Ne nuk mjaftohemi nga kto lloj muzesh. Sidomos e vlerësojmë shumë arkitekturën dhe ndërtesën origjinale. Qelitë e errëta dhe të ngushta. Ekspozimi mjaft i mirë i mizorive të regjimit komunist.” L.P. Belgjikë, 2017

²¹“Muzeu i Vuajtjeve të Diktaturës në Shkodër gati për vizitorët”. *Gazeta Shkulli*, 30 korrik 2013, konsultuar për herë të fundit më 25 prill 2020, <https://www.shqiperia.com/Muzeu-i-Vuajtjeve-Diktatures-ne-Shkoder-gati-per-vizitoret-.21885/>.

Në këtë mënyrë muzeu pretendon të ofrojë jo vetëm një përvojë konjiktive, por edhe një përvojë që përfshin anën fizike, ku vizitori duhet të përfshihet, të ecë nëpër kohë, të ndiejë tmerret, të ketë përvojë të drejtpërdrejtë. Kjo pjesërisht mund të jetë një përgjigje ndaj kërkesave turistike për përvojën autentike. Pra, duket se muzetë e kujtesës perceptohen të jenë mjaft të pajisur për të krijuar një përvojë emocionale, që do të ndikojë te vizitori moralisht në një mënyrë që një muze historik apo ndonjë lloj tjetër nuk mund ta bëjë, duke krijuar kështu "kujtesën protezë" të Alison Landsberg, e cila është një "formë e re e kujtesës" që shfaqet mes një personi dhe një tregimi historik për të kaluarën, në një vend eksperimental si një kinema apo muze. Sipas Landsberg-ut, përmes angazhimit të vizitorit, këto vende lejojnë individin të "përfshijë veten në një histori të madhe, dhe të krijojë kujtimin e një ngjarjeje të së kaluarës, ku ai ose ajo nuk jetonte" (Landsberg 2004, 2). Sipas Landsberg-ut, aftësia e tyre e veçantë për të arritur në zemrat dhe mendjet e vizitorëve dhe qëllimet e tyre për të shndërruar në mënyrë morale publikun e tyre i bën ata një formë unike dhe krejtësisht të re kulturore për të kujtuar të kaluarën.

Së treti, funksioni, që është dhe më i rëndësishmi dhe karakteristikë e këtyre muzeve, që ka si qëllim për të edukuar moralisht vizitorin. Kjo arrihet nëpërmjet ekspozitave dhe narrativave. Muzeu është i organizuar në dhoma të veçanta. Dhoma e parë që mund të quhet ndryshe hyrja e muzeut të informon për numrin e personave të vdekur në këtë ish-burg si dhe të jep një informacion të përgjithshëm për historinë e burgjeve të qytetit të Shkodrës. Pasi vizitori, së pari, është bombarduar nga "historia", më pas përfshihet më tej duke shkuar në zonën e ish-burgut. Kalimi këtu realizohet nga elementë që të kujtojnë prangat, zinxhirët, apo edhe sende që kanë shërbyer si pjesë e torturave. Zona e ish-burgut përbëhet nga 42 qeli të vogla me nga një numër mbi derë shkruar si me thëngjill, që dikur ishin dhomat e burgut dhe shërbenin për izolimin e të burgosurve.



Korridori original i burgut gjatë viteve të komunizmit dhe korridori i muzeut sot²²

Mënyra e paraqitjes së ekspozitës është tipike e këtyre llojeve të muzeve, ku teknikat janë shumë eksperimentale duke krijuar hapësira të mbyllura, të ngushta e pa dritë për të ndihmuar në rigjenerimin e përvojës së viktimave. Gjatë gjithë kohës, ciceroni i muzeut i rrëfen vizitorit histori individuale të terrorit dhe vuajtjes si dhe ekzekutimet e qindra personave. Kjo e bën vizitorin të ecë në hapat e atyre që u futën në këtë ish-burg dhe nuk dolën më.

Në librin e përshtypjeve të muzeut vizitorët shpesh shprehin emocione: “Në qelitë e burgut ka shumë errësi, mbase për efekt, por ka raste që ndjen frikë dhe duket sikur nuk mund të dalësh më nga aty.” E. S. Washington 2017

Dhomat, secila në tipologjinë e saj, e përshkruajnë komunizmin në një kontekst më të gjerë. Ato mund të ndahen në:

- Dhoma tematike, e cila paraqet një pasqyrë të qartë të asaj që ishte jeta gjatë atyre kohërave.
- Dhoma e vogël, ku janë përzgjedhur artikuj të asaj kohe që shfaqin idenë e represionit, rezistencës dhe opozitës.
- Dhoma e ekspozitës, ku ndodhen të ekspozuara një grup objektsh

²² Fotoja me ngjyra është bërë nga autorja në Muzeun e Kujtesës, ndërsa fotoja bardhë e zi është tërhequr nga Bushati 2001, 17.

të punuara nga të burgosurit: objekte të përditshme jetësore (kuti duhani, lugë druri, enë të punuara brenda në burg), libra të ndaluar, uniforma ushtarake etj. Gjithashtu, nëpër stenda ka shumë informacion dhe dokumente origjinale të kohës, që fillon me periudhën e krijimit të partisë komuniste, kryengritjet e para antikomuniste në Shqipëri, jeta nën regjimin komunist, për gjyqet të ndryshëm, dëshmi penaliteti, që tregojnë se si janë zhvilluar gjyqet, letra burgu dhe korrespondenca, objekte të tjera, shkrime origjinale të asaj kohe dhe gjithë ky rrëfim përfundon me rrëzimin e komunizmit në vitin 1991. Pra, kjo dhomë është mjaft e rëndësishme për të marrë një informacion të jetës në periudhën e komunizmit.



Foto nga dhomat tematike që janë pjesë e muzeut

Pjesë e muzeut janë dhe oborret e ajrimit, të cilët janë të ndarë me mure të larta, në mënyrë që të burgosurit të mos komunikojnë me njëri-tjetrin. Përgjegjësi i muzeut tregon se ky është vendi ku të dënuarit dilnin për ajrosje. Telat me gjemba që rrethonin dikur hapësirën në lartësinë e mureve të burgut e përligjinin dhunën psikologjike që vinte nga qyteti.



Oborri i ajrimit në periudhën e komunizmit dhe oborri i ajrimit sot si pjesë e muzeut.

Gjithashtu, janë shumë me interes qelitë e ruajtura të paprekura, së bashku me shënimet e bëra nga vetë të burgosurit. Mund të shohësh fare qartë simbolet e "gdhendura" nëpër muret e burgut, të tilla si: xhami me minare, kryq, yll e hënë, numra që ngjasojnë me mbajtjen e një kalendari etj. Për këto simbole, përgjegjësi i muzeut tregon se do duhet t'i nënshtrohen një "ekspertize" për të çkoduar shenjat e vijave, vizatimeve, fjalëve apo lutjeve, pasi shkrimet e vona mund të fshehin nën to semiotikën e përdorur në atë kohë e ato kushte nga të burgosurit politikë. Meqë ky ka qenë edhe burg, ku "kanë vuajtur" dhe spiunë²³ dhe, deri vonë, ka shërbyer si burg për civilët, do duhej si fillim të spastrohej shtresa historike e burgut komunist, që ka humbur prej gjurmëve të një burgu tjetër. Duke pasur parasysh luftën e hapur të diktaturës kundër fesë, këto mesazhe në muret e burgut mund t'i kuptojmë në dy dimensione, së pari si mënyrë rezistence dhe lirie brenda mureve të burgut (në mesin e tyre u krijua një hapësirë e sigurt që u siguronte të burgosurve një ndjenjë lirie, pa pasur nevojë për të dhënë shpjegime) dhe, së dyti, si formë provokimi (duke pasur brenda burgut edhe spiunë, simbolet fetare mund të vinin edhe si formë provokimi). Këto qeli

²³At Zef Pllumi në librin e tij *Rrno vetëm për me tregue* në shumë nga kapitujt tregon eksperiencën e tij, ku thekson se për të gjetur të burgosurit më të rrezikshëm, komanda kishte gjetur një rrugë duke fshehur spiunët mbas njerëzve të ndershëm, kështu që një ndër dy të burgosur ishte spiun. Shih: (Pllumi 2015)

sjellin dhe kulmin e përvojës ekspozuese, pasi vizitori inkurajohet më pas të hyjë në qelitë e torturës dhe të paraburgimit.



Shënime të bëra nga të burgosurit, sot pjesë e muzeut

- Dhoma e torturës; në murin e saj varen instrumente të torturës, pa shumë sqarime. Nëpërmjet ndriçimit të zbehtë dhe sendeve të vëna aty, vizitori lihet të imagjinojë se çfarë lloje torturash u nënshtroheshin viktimat. Dhoma e ekspozitës qëllimisht shfaq dhe përshkruan natyrën e inskenuar të gjyqeve të shfaqjeve komuniste, dhe të gjitha dokumentet që lidhen me gjykimet, aktakuzat, dënimet, ankesat dhe hetimet për të bërë lidhjen me këtë dhomë.



Por çfarë kuptimi mund të kenë për vizitorët, nëse atyre nuk u shpjegohet se çfarë ndodhte në këto dhoma hetuesie? Në këtë pjesë futen në lojë vetë ish personat e dënuar, të cilët rrëfejnë histori personale rrëqethëse, shumë të frikshme, të poshtërimit dhe terrorit. Në rastet kur ata nuk mund të jenë të pranishëm, kjo dhomë bëhet pjesë narrative e përgjegjësit të muzeut apo e vetë autobiografive të shkruara në vitet e fundit për këtë ish-burg, ku tregohet se në dhoma të tilla i shtrëngonin njerëzit të tradhtonin jo vetëm të tjerët, por dhe veten e tyre. Pra, nëpërmjet kësaj dhome, që është dhe pika kulmore e muzeut, vizitorit i ofrohet një udhëtim i ngadalshëm në kohë, duke i rrëfyer histori personale torturash dhe dhune ushtruar aty:

“Në njërën anë të burgut të Shkodrës ishte dhe hetuesia, ku ushtrohej dhunë e vazhdueshme ndaj të burgosurve. Madje për të burgosur të veçantë torturat bëheshin haptazi në sy të të gjithë të burgosurve. Prandaj muzeu përshkruan shumë qartë periudhën e dhimbshme të atyre që vuajtën dënimin në qelitë dhe birucat e tij”.²⁴



Nga rrëfimet dhe dëshmitë e ish-personave të dënuar si dhe të dhënat e tjera të kësaj periudhe kohore, rezulton që, në këtë ish-burg, të jenë kryer të

²⁴ Plani, Lekë. “Muzeu i Kujtesës historike në Shkodër”. *DW*, 26 gusht 2013, konsultuar për herë të fundit më 23 prill 2020, <https://www.dw.com/sq/muzeu-i-kujtes%C3%ABs-historike-n%C3%AB-shkod%C3%ABr/a-17044472>.

gjitha llojet e torturave, të cilat mund t'i klasifikojmë në tre kategori: fizike, psikologjike apo të dyja bashkë. Për identifikimin sa më të qartë të tyre do sjellim dhe shembuj nga historitë personale të treguara për vizitorët në këtë burg.

- Torturat fizike. Ish-të burgosurit i referohen kësaj si metoda më e përdorshme e torturës gjatë marrjes në pyetje. Sipas të burgosurve, torturat më të përdorura kanë qenë djegie e mishit me cigare, thyerje kockash dhe shkulje e mishit me darë, përdorimi i korrentit, jeleku i torturës, dëmtimi i organeve gjinitale, lënia pa bukë, pa ujë e pa gjumë, në këmbë për ditë të tëra, varje në qafë të zinxhirëve me pesha, varje prej krahësh të lidhur mbrapa, në një dritare ose çengel në lartësi, mbushja e gojës me kripë etj.

Disa prej torturave të konsiderueme standard, të ushtrueme mbi viktimat e këtij ish-"Burg Sigurimi", do të konsistojnë në goditjen e viktimës me dru të fortë ose kërbaç të trashë; në varjen për shpatullash me anë litari të varun për hekura të dritares së qelisë, pak nën tavan; në privimin e tij nga e drejta me marrë ushqimin që familja ia sillte ditë për ditë dhe gjithashtu edhe nga e drejta për të marrë ujë... torturë mbi çdo torturë ka kenë ajo e "hekurit të skuqun" mbi trupin e zhveshun të viktimës, si dhe thyemja e kockave të kupave të gjunit me çekan, torturë që dihet që ka qenë ushtruar mbi avokatin Myzafer Pipa, me urdhën direkt të E. Hoxhës!²⁵

- Torturat psikologjike që shkatërronin personalitetin e viktimës. Këtu theksi ishte në efektet mentale. Në mesin e torturave të tilla, ish të burgosurit japin përshkrime të privimit nga identiteti, poshtërim, rraskapitje, përdorim të vazhdueshëm të errësirës (apo lidhjes së syve), kërcënimet për t'u torturuar, gjymtuar, vvarë si dhe duke kërcënuar pjesëtarët e familjes dhe miqtë etj:

²⁵ Bushati Ahmet. "Muzeu i Viktimave të komunizmit në Shkodër-Fjala e Ahmet Bushatit". *Shkrime nga Lazër dhe Jozef Radi*, 27 shtator 2014, konsultuar për herë të fundit me dt. 18 prill 2020,

<http://www.radiandradi.com/muzeumi-i-viktimave-te-komunizmit-ne-shkoder-fjala-e-ahmet-et/>.

“Ishte tetori i vitit 1947 kur Dom Anton Muzaj dhe Atë Frano Kiri u arrestuan dhe iu nënshtruan torturave më të tmerrshme. I detyronin të qëndronin në këmbë, me majën e hundës të mbështetur tek muri, të lidhur duar e këmbë, për ditë e net të tëra, ndërsa etja ua shtonte edhe më shumë vuajtjet. Çdo ditë, dy të burgosur, me radhë, lanin dyshtemenë e korridorit të burgut, shpesh të lagur me gjak. Dom Antoni u kërkoi atyre që të mos e thanin krejt ujin, që të mund të pinte pak prej tij. Menjëherë i hodhën përtokë për të lëpirë si qentë ndonjë pikë ujë që mund të kishte mbetur në atë dyshteme të lagur.²⁶

- Torturat e përbashkëta fizike dhe psikologjike. Këto janë shembuj të keqtrajtimit fizik që kishin një komponent më të spikatur të ankthit mendor. Disa shembuj të torturave të tilla përfshinin vendosjen e të burgosurve në errësirë të plotë ose në qeli, duke lejuar me qëllim që minjtë e kanalizimeve të kishin qasje në qelitë e vetmuara, apo privimin e tyre, duke i vënë të burgosurit në qeli të vogla deri në 1m x 0.5 m, ku i burgosuri as nuk mund të shtrihej, as nuk mund të rrinte në këmbë, por vetëm ulur këmbëkryq. Marie Tuci, e cila u arrestua më 10 gusht 1949, përshkruan se si në burg u nënshtrohej shpesh marrjeve në pyetje dhe rrahjeve mizore dhe se qelia e saj ishte një vrimë pa dritë dhe pa ajër. Ajo tregon se kur e çuan në spital familjarët e saj nuk e njohën.²⁷

Të gjitha këto histori të treguara në këtë punim për të krijuar një imazh të informacionit që merret brenda në muze, së bashku me ekspozitën, ofrohen për vizitorin duke treguar në këtë mënyrë komunizmin si diçka të frikshme, manipuluese dhe të rrezikshme në të tashmen, sidomos për ata që nuk e jetuan atë periudhë, apo të huajt që nuk e njohin mirë historinë e komunizmit në Shqipëri.

²⁶“Në ish-burgun e sigurimit të shtetit Shkodër”. *Kisha katolike në Shqipëri, Arqipeshkëvia Shkodër-Pult*, 2009, konsultuar për herë të fundit me dt. 20 qershor 2020,

<https://www.kishakatolikeshkoder.com/martiret-e-komunizmit/udha-e-kryqit-ne-gjurmimet-e-martireve-te-komunizmit-1946-1990/>.

²⁷ Po aty.

Pra, nëpërmjet ekspozitës dhe narrativës që i bëhet vizitorit, zhytja e tij në të kaluarën e pafajshme dhe të viktimizuar është e plotë, dhe vizitori ka për qëllim të dalë nga ekspozita duke kuptuar se çfarë regjimi iu nënshtruan mijëra viktima. Kjo empati, pra, ka për qëllim të mbështesë një vlerësim për të sotmen që zëvendësoi komunizmin. Kjo përpjekje, për ta bërë vizitorin të "përjetojë" të kaluarën në një mënyrë që çon në empati me viktimat, sado të ndryshme të jenë ato, ka për qëllim të krijojë "kujtesën protezë" të Landsberg-ut, e cila nuk është e vetë ngjarjes aktuale, por e një përvojë të ndërmjetësuar nga e kaluara (Landsberg 2004, 17). Potenciali që vizitorët të krijojnë një kujtim të një të kaluare, që nuk u përjetua në të vërtetë, përmes një forme të ndërmjetësuar kulturore, theksohet nga Landsberg-u si hapja e derës për transformimin etik dhe moral. Ajo, nëpërmjet kësaj, sheh në këtë kujtesë potencialin për të bërë ndryshime sociale dhe politike; sipas Landsberg-ut, "kujtimet protezë hapin horizonte kolektive të përvojës dhe i hapin rrugën aleancave politike të papritura" (Landsberg 2004, 143). Kështu, sipas Landsberg-ut, kujtesa protezë mund të sjellë ndryshim të vërtetë. Përdorimi i ekspozitave të muzeut të kujtesës për të frymëzuar empatinë dhe identifikimin, në mënyrë që të ndryshojë ndjeshmërinë morale të vizitorit, është pikërisht ajo që arrihet në Muzeun e Kujtesës në Shkodër si dhe një nga qëllimet kryesore të muzeve të kujtesës. Disa nga përshtypjet e vizitorëve e konfirmojnë këtë. Këto pohime janë transkriptuar nga një seri intervistash të ndërmarra gjatë një ekspedite etnografike në Shkodër dhe zbulojnë përgjigjen emocionuese ndaj mënyrës se si e shohin muzeun vizitorët, që është dhe një tregues i rëndësishëm për këta muze.²⁸

"Jam shumë e prekur emocionalisht. Kam mësuar aq shumë për komunizmin në Shqipëri dhe për këtë qytet të vogël, ku mendoj që lufta ndaj fesë ka qenë mjaft mizore. Pastaj vuajtjet, torturat e bëra për pjesëtarët e bashkisë fetare më mërzhisin dhe më nervozojnë." H. Francë, 2018

"Në kompleksin e burgut ndjeva që historia po gjallërohej dhe po mund të ndjeja praninë e të gjithë atyre që vuajtën dhe vdiqën në këtë vend." N.W. Michigan, 2018

²⁸ Këto intervista janë realizuar nga autorja në janar të vitit 2018.

“Pjesa më e rëndësishme për mua ishin historitë e vuajtjeve dhe të torturave. Më kanë mbetur në kujtesë disa dhe pyes veten se si është e mundur që këto tortura të kryhen nga njerëzit për njerëzit. Ndjej dhimbje dhe mërzitje në të njëjtën kohë.” X.X. 2018

Për ta përmbyllur, kuptojmë se muzetë e kujtesës janë pjesë e rëndësishme e tranzicionit për trajtimin e së kaluarës. Ata na mundësojnë të shohim atë që shoqëritë duan të mbajnë mend dhe çfarë ata duan të harrojnë për komunizmin. Politikat e kujtesës që zbatohen, ofrojnë një interpretim të së kaluarës, të përforcuar fort nga antikomunizmi. Ashtu si e gjithë politika e kujtesës, ato janë në të njëjtën kohë politikat e harresës, në kuptimin që nxjerrin në pah disa aspekte të së kaluarës (vuajtjet e pësuar, torturat çnjerëzore, rezistencën dhe heroizmin e popullit), por lënë pas të tjerat (bashkëpunimin apo mbështetjen për regjimin komunist etj.). Po ta shohim nga kjo pikëpamje, ata mund edhe t'i krahasojmë me muzetë e ndërtuar gjatë periudhës komuniste, ku dallimi kryesor, në lidhje me këtë të fundit, qëndron në një interpretim të ndryshëm të së kaluarës. Megjithatë, ky proces dëshmon vështirësitë për t'u përballur me të kaluarën dhe gjetja e zgjidhjeve nëpërmjet formës së re të perkujtimit me muzetë e kujtesës. Bazuar në rastin në fjalë, konfirmuam se Muzeu i Kujtesës në Shkodër bën pjesë plotësisht në muzetë tradicionale të kujtesës së komunizmit, duke plotësuar funksionet kryesore të tij, duke theksuar historinë dhe origjinalitetin (diçka që ka ndodhur në këtë qytet dhe në këtë ndërtesë), kujtesën (dhuruar nga personat që kanë vuajtur atje) dhe edukimin (nëpërmjet mesazhit që i transmeton shoqërisë, që nuk duhet të harrohet kjo periudhë çnjerëzore dhe as të lejohet që ajo të përsëritet).

Në të ardhmen, një analizë e plotë rreth muzeve të tjerë, që trajtojnë periudhën komuniste në Shqipëri, duhet marrë parasysh për të kuptuar nëse trajtimi i ekspozitave të tyre mbetet si përgjigje e shqetësimeve politike apo ato përpiqen të marrin parasysh të gjitha aspektet e të së kaluarës komuniste, duke qenë më të vëmendshëm ndaj kompleksitetit të realitetit historik.

Bibliografi

Arendt, Hannah. 1958. *The Human Condition*. London: University of Chicago press.

- Bennett, Tony. 1999. "The Exhibitionary Complex". Në *Representing the Nation: A Reader* përgatitur nga David Boswell dhe Jessica Evans. New York: Routledge.
- Broci, Ermela. 2018. "Turizmi i errët: Piramida si atraksion turistik", *Antropologji* 1: 139-164.
- Bushati, Ahmet. 2001. *Në gjurmët e një ditari*, Shkodër: Camaj-Pipa.
- Bushati, Ahmet. 2007. *Në gjurmët e një ditari: Shkodra në tri vitet e saj të parë nën komunizëm, në sigurim, ndër burgje e kampe*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- Bushati, Hamdi. 1998. *Shkodra dhe Motet (vëllimi i dytë)*, Shkodër: Idromeno.
- Butka, Uran. 2013. *Kryengritjet e para kundër komuniste*, Tiranë: ISKK.
- Duncan, Carol. 1995. "The art museum as a ritual of citizenship". Në *Exhibiting Cultures: The Poetics and Politics of Museum Display*, përgatitur nga Ivan Karp dhe Steven D. Lavine: 88-103 Washington, DC: Smithsonian Institution Press.
- Gamboni, Dario. 1997. *The Destruction of Art. Iconoclasm and Vandalism since the French Revolution*. London: Reaktion Books.
- Gashi, Rexhep. 2012. "Llojet e burgjeve dhe kampeve të punës dhe pozita e personave të dënuar në Shqipëri gjatë periudhës së diktaturës komuniste." *Thesis* 1: 27-50
- Huyssen, Andreas. 1995. *Twilight memories: Marking time in a Culture of Amnesia*. Në Florence." *Art History* 33(5): 836-855. New York: Routledge.
- Kurti, Donat At. 2003. *Provinca Françeskane Shqiptare*. Shkodër: Bukinist.
- Landsberg, Alison. 1995 "Prosthetic Memory: Total Recall and Blade Runner", *Body and Society*, 3-4 (1): 175-189.
- Mirdita, Pjerin. 2017. "Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës; nga vend vuajtjeje dhe torturash, në muze për të përkujtuar viktimat e regjimit komunist", *Gegnia*, 3: 111-115.
- Pllumi, Zef. 2015. *Rrno vetëm për me tregue*. Shkodër: Botime Françeskane.
- Prendushi, Mikel. 1984. *Kolë Idromeno. Jeta dhe veprat*. Tiranë: 8 Nëntori.
- Sulo, Haxhi dhe Pëllumb Kaso. 1995. *Diktatura: Akuza dhe apolojia: 2.400.000 vite burg, 600.000 vite internim 2.025.000 vite pune e detyruar*. Tiranë: Alta.
- Terry, Allie. 2010. "Criminals and Tourists: Prison History and Museum Politics at the Bargello.

Wight, Craig. 2009. "Contested national tragedies: an ethical dimension".
Në *The Darker Side of Travel: the Theory and Practice of Dark
Tourism* përgatitur nga Richard Sharpley dhe Philip R. Stone: 129-144.
Bristol: Multilingual Matters & Channel View Publications